



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës



Raport i Punës për tremujorin e parë

Janar-Mars, 2025

Prishtinë, Prill 2025

Ky raport paraqet punën e OMK-së për periudhën Janar-Mars të vitit 2025.

Raporti përmbledhë aktivitetet e të gjitha njësive organizative të OMK-së, duke u koncentruar në fushat kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së Odës.

Përmbajtja:

1. Përmbledhje ekzekutive.....	4
2. Këshilli Drejtues.....	4
3. Këshilli Mbikëqyrës	5
4. Anëtarësimi	5
5. Mbikëqyrja etiko-profesionale.....	6
6. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional	7
7. Licencimet.....	8
8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së	8
9. Komisioni për Edukim Specialistik	8
10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke.....	9
11. Raporti financiar.....	9
11.1. Raporti financiar për periudhën Janar - Mars 2025.....	9
11.2. Prokurimi	10
12. Aktivitete të tjera	10
12.1 Revsita Mjeku- Fiziatria, Fizioterapia dhe Mjekësia Sportive	10
12.2 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike	10
13. Plani i veprimit për 2025	11

1. Përmbledhje ekzekutive

Gjatë këtij tremujori, u mbajt një mbledhje nga kuvendi i OMK-së.

Me datë 20 shkurt 2025 u mbajt mbledhja e X e legjislaturës së tretë të Kuvendit të OMK-së. Në këtë mbledhje u shqyrtuan dhe u aprovuan:

- Raporti i punës së OMK-së për vitin 2024;
- Projekt buxheti i OMK-së për vitin 2025
- Plotësim/Ndryshimi i Rregullorës për Anëtarësim, Licencim dhe Rilicencim

Gjithashtu në këtë mbledhje është bërë dhe betimi i dy anëtarëve të rinj të Kuvendit nga dy njësi zgjedhore ku janë zëvendësuar përfaqësuesit nga Spitali i Përgjithshëm i Gjilanit dhe nga Klinika e Anestezionit

2. Këshilli Drejtues

Këshilli Drejtues ka mbajtur pesë takime, lëndët e shqyrtuara janë si më poshtë:


Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën janar - mars	Vendimet/Përgjigjet sipas kërkesave/ ankesave të pranuar për periudhën janar - mars	Vendimet në procedurë	Vendimet e Këshillit Drejtues për periudhën janar - mars	Vendime/Pergjigje për lëndët e bartura nga periudhat paraprake
Këshilli Drejtues i Odës	26	26	0	<ul style="list-style-type: none"> - Vendim për aprovim të planit buxhetor të OMK-së për vitin 2025 - Vendim/propozim për zëvendësim të anetarit të KQZ-së së OMK-së; - Vendim për aprovim të raportit të Punës për vitin 2024; - Vendim për themelim të Komisionit Ad-Hoc për vlerësim dhe përzgjedhjen e 10 punimeve shkencore; 	0

3. Këshilli Mbikëqyrës


Këshilli Mbikëqyrës ka mbajtur pesë takime ku i kanë shqyrtuar Raportin e tremujorit të katërt të punës së OMK-së, Raportin financiar për periudhën tre mujore tetor-dhjetor 2024, Vendimet e Këshillit Drejtues si dhe të organeve të tjera të OMK-së.

4. Anëtarësimi

Në Odën e Mjekëve të Kosovës u anëtarësuan 103 mjekë, 4 mjekë të punësuar në sektorin privat, 99 mjekë të papunë.




Grafikoni 1. Anëtarësimet për periudhën kohore Janar – Mars 2025



Grafikoni 2: Totali i përgjithshëm i anëtarëve deri më datën 31 Mars 2025

Gjatë kësaj periudhe janë rianëtarësuar 11 mjekë, si rezultat numri total i anëtarëve deri me datën 31 Mars është 5538 mjekë.



Grafikoni 3: Totali i përgjithshëm i anëtarëve

5. Mbikëqyrja etiko-profesionale

Për ta pasqyruar ecurinë e mbikëqyrjes etike dhe profesionale pranë Prokurorit të OMK-së, në mënyrë tabelare do të paraqesim ushtrimin e funksionit të tillë nga ana e Prokurorit të OMK-së.

ORGANI	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën TM1	Vendimet sipas procedurës së zhvilluar për periudhën TM1	Sanksionet e shqiptuara për periudhën TM1	Sanksionet e ekzekutuara për periudhën TM1	Lëndët e bartura nga periudhat paraprake	Lëndët në shqyrtim
Prokurori i Odës	9	19	N/A	N/A	46	36
Këshilli Etik	24	6	Rekomandim kolegjale 3	Rekomandim kolegjale 1	17	33
Gjyqi i Nderit	1	2	///	///	1	0
Certifikatat e kaluarës etike	121	///	///	///	///	///

Gjatë periudhës së tremujorit të parë janë lëshuar 121-certifikata mbi të kaluarën etike dhe profesionale, ku 105-certifikata janë lëshuar për mjekët që kanë marr certifikata për shtesa mbi pagë në sektorin publik, Rregullorja nr. 02/2023, dhe mjekët që kanë marr certifikata për përdorim brenda territorit të Kosovës. Ndërsa, 16-certifikata janë lëshuar për mjekët për përdorim jashtë territorit të Kosovës.

6. Edukimi i Vazhdueshëm Profesional

Komisioni për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional ka akredituar gjithsej 63 aktivitete, prej të cilave 26 aktivitete janë ligjërata vjetore. Në kuadër të aktiviteteve të akredituara, prej këtyre akreditimeve 5 janë me taksë administrative.

Pas shqyrtimit të aplikacioneve për përkrahjen e aktiviteteve të shoqatave profesionale të cilat kanë aplikuar sipas Konkursit Publik, 8 aktivitete janë akredituar me dhe janë aprovuar për përkrahje financiare nga OMK, ndërsa aplikimi i një shoqate profesionale është refuzuar për shkak të mosplotësimit të kushteve të përcaktuara. Gjatë kësaj periudhe ka pasur 1 kërkesë për anulimin e certifikates së akreditimit të aktivitetit. Po ashtu, është refuzuar 1 kërkesë për përkrahje financiare individuale për individë që nuk kanë përmbushur kriteret e nevojshme për mbështetje.




Oda e Mjekëve të Kosovës ka implementuar trajnimin disa javor për ultratingull të abdomenit, në bashkëpunim me komunat e Drenasit, Gjilanit dhe Obiliqit. Ky trajnim përfaqëson një nga aktivitetet kryesore në kuadër të angazhimeve të OMK-së për edukimin e vazhdueshëm profesional të stafit shëndetësor në nivel lokal.

Qëllimi i këtij programi trajnues është ngritja e kapaciteteve profesionale të mjekëve, si dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimeve diagnostike për pacientët. Një element i veçantë i këtij trajnimi është fokusi praktik, ku pjesëmarrësit kanë mundësinë të aplikojnë vetë metodat e ultrasonografisë abdominale, duke përfituar njohuri dhe aftësi të drejtpërdrejta në përdorimin e pajisjeve përkatëse.

Ky aktivitet është bashkëfinancuar nga Oda e Mjekëve të Kosovës dhe nga komunat përkatëse.

7. Licencimet

Komisioni për Licencim dhe Rilicencim profesional gjatë periudhës janar-mars 2025, ka lëshuar gjithsej 248 licenca me kategoritë si në grafikun e mëposhtëm:



8. Komisioni për Çështje Etike i OMK-së

Komisioni për Çështje Etike ka pranuar gjithsej 21 kërkesa për leje-hulumtim. Poashtu, Komisioni për Çështje Etike i OMK-së ka pranuar gjithsej 5 kërkesa për raport përmbyllës.

Për 21 kërkesa të shqyrtuara komisioni ka nxjerr 9 Vendime aprovuese, dhe 3 vendime janë marrë për lëndët e bartura nga periudha TM4 2024. Rrjedhimisht janë të bartura 12 lëndë për tu shqyrtuar në periudhën vijuese.

KÇE për 17 raporte përmbyllëse të shqyrtuara ka nxjerr 3 Vendime aprovuse. Ndërsa 2 vendime janë refuzuese. Rrjedhimisht janë bartur 12 lëndë për tu shqyrtuar në periudhën vijuese.

9. Komisioni për Edukim Specialistik

Komisioni për Edukim Specialistik ka mbajtur një takim. Përgjatë këtij takimi komisioni ka diskutuar lidhur me rregulloren e Komisionit.

10. Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke

Komisioni për Solidaritet dhe Ndihmë Reciproke i OMK-së ka pranuar gjithsej 6 kërkesa për përkrahje financiare dhe 2 kërkesa për shpenzime të varrimit.

Komisioni ka nxjerrë 4 vendime për aprovimin e kërkesës për ndihmë financiare. Komisioni ka nxjerru 1 vendim për aprovimin e kërkesës për shpenzime të varrimit. Rrjedhimisht janë bartur 3 lënd për tu shqyrtuar. 2 kërkesa janë për përkrahje financiare dhe 1 është për shpenzime të varrimit.

11. Raporti financiar

11.1. Raporti financiar për periudhën Janar - Mars 2025

1.0 Të hyrat:		
1.1 Paraja në bankë me 31.12.2024	€ 843,465	
Total Paraja në bankë me 31.12.2024		€ 843,465
1.2 Të hyrat	Realizimi: TM1	TOTAL
1.2.1 Të hyrat nga anëtarësia:		
1.2.1.1 Anëtarësimi i mjekëve shtetas kosovarë	€ 342,715	€ 342,715
1.2.1.2 Anëtarësimi i mjekëve shtetas jo kosovarë	€ 1,800	€ 1,800
1.2.2 Licencimi	€ 13,647	€ 13,647
1.2.3 Të hyrat e tjera*	€ 11,709	€ 11,709
Të hyrat deri me 31.03.2025	€ 369,871	€ 369,871
Paraja në bankë me 31.12.2024		€ 843,465
TOTAL TË HYRAT		
2.0 SHPENZIMET		
	Shpenzimet: TM1	TOTAL
2.1 Paga, meditje dhe kontributet pensionale	€ 84,791	€ 84,791
2.2 Material shpenzues	€ 518	€ 518
2.3 Reprerentacioni	€ 846	€ 846
2.4 Edukimi i vazhdueshëm profesional	€ 52,796	€ 52,796
2.5 Shpenzimet e tjera*	€ 7,598	€ 7,598
2.6 Shpenzimet e asetëve	€ -	€ -
2.7 Përkrahje financiare në kuadër të fondit për solidaritet	€ 8,450	€ 8,450
TOTAL SHPENZIMET 31.03.2025	€ 154,999	€ 154,999
Neto të hyrat për TM 1 2025		€ 214,872
TOTAL BILANCI 31.03.2025		€ 1,058,337

Faksimili, Faksimili i dytë, Certifikata për të kaluarën etike profesionale, Taksa për paraqitjen e provimit, Kongreset, simpoziumet, seminarët, Lejimi për hulumtime për persona juridik, Të ardhurat nga interesi BKT, Dhurata / donacione, Të ardhurat të tjera.

2.5*Faksimili, Shpenzimet për botimin e revistës, Organizimi i mbledhjeve të kuvendit, Shpenzimet e ID kartelave të Odë, Shpenzime të përkthimeve/lektorimit, Meditje për udhëtime zyrtare, Trajnime për stafin, Mirembajtja e softverit për financa, Shpenzimet e tel., Shpenzimet e int., Shpenzimet e postës, Pajisje të IT, Shpenzime bankare, Shpenzimet e pastrimit, Shpenzimet e transportit, Shpenzimet e tjera operative.

11.2. Prokurimi

Gjatë periudhës kohore janar – mars 2025 u zhvillua procedurë e hapur e prokurimit Kontratë për shërbime të transportit ajror, ku dhe është arritur marrëveshje një vjeçare me operatorin ekonomik të suksesshëm.

12. Aktivitete të tjera

12.1 Revista Mjeku- Fiziatria, Fizioterapia dhe Mjekësia Sportive

Vëllimi 5, Numër 1 i Revista Mjeku ka në përmbajtjen shkrijen e temave rreth Fiziatriisë, Fizioterapisë dhe Mjekësisë Sportive. Ky numër është publikuar gjatë muajit Mars 2025 dhe përbëhet gjithsej nga 33 artikuj të përmbledhura në 93 faqe. Revista është publikuar në Ëeb-faqen e OMK-së dhe në faqe zyrtare të facebookut.

Të bashkangjitur mëposhtë gjeni linkun e publikimit të këtij numri:

[Revista Mjeku - Fiziatria, Fizioterapia dhe Mjekësia Sportive](#)

12.2 Bashkëpunimi profesional dhe veprimtaria ekspertike

Në kuadër të kompetencës publike lidhur me mbikëqyrjen e veprimtarisë profesionale të mjekëve, Kryetari i OMK-së duke u bazuar në kompetencat ligjore sipas Ligjit për OPSH-të, në bazë të kërkesave nga Këshilli Etik i OMK-së, Prokurori i OMK-së, Gjykatat Themelore ka caktuar ekspert apo grupe të ekspertëve lidhur me konstatimin e përgjegjësisë profesionale mbi zbatimin e procedurave mjekësore nga mjekët gjegjës.

Organi	Numri i lëndëve të pranuar për periudhën janar-mars	Vendimet sipas urdhëresave/kërkesave të pranuar për periudhën janar-mars	Në procedurë	Raportet e ekspertizave të përfunduara për periudhën janar-mars	Vendime për lëndët e bartura nga periodat paraprake
Kryetari i Odës	2	0	0	0	0

Në këtë periudhë kohore gjashtë lëndët e pranuar nga Gjykatat dhe Prokuroritë janë kthyer prapa me arsyetimin sepse nuk është duke u ekzekutuar asnjë pagesë e ekspertëve të caktuar nga Oda e Mjekëve ndërsa është kërkuar nga Komisioni për Çështje Etike, Prokurori dhe zv.Prokurori i OMK-së, për caktim të ekspertëve.

13. Plani i veprimit për 2025

- Vazhdimi i realizimit të Projektit për ndërtimin e objektit për të gjitha OPSH-të, financuar nga Projekti KSV/017 “Përkrahja për sektorin e shëndetësisë” dhe OPSH-të. Në këtë fazë sipas procedurave administrative dhe hapave të planifikuara deri në përfundim të projektit, kemi pranuar lejen për kushtet ndërtimore nga komuna e Prishtinës. Hapi i ardhshëm i projektit është që të bëhet plani detal i objektit nga arkitektët, si rezultat OPSH-të së bashku me projektin Luxembourg Development të bëjnë hapjen e tenderit për fillimin e punimeve.
- Organizimi i Kongresit të VII të Mjekësisë.
- Botimi i numrave në vazhdimësi të “Revistës Mjeku”.
- Vazhdimi i zbatimit të projekteve për profilizim dhe shkollim specialistik jashtë vendit, bazuar në marrëveshjen mes OMK-së dhe SHSKUK.
- Organizimi i zgjedhjeve për legjislaturën e IV-të të OMK-së.